



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS NË MALISHEVË



Kryetari i Komunës

Nr. 01/____

Datë; 22/01/2019

Në bazë të nenit 13 dhe 58(shkronja b dhe d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me nenin 2 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal , Statutit të Komunës së Malishevës neni 30, Rregullores nr.04/2017, mbi kriteret standardet the procedurat e financimit publik të OJQ-ve;

Kryetari i Komunës së Malishevës me datë 22.01.2019 merr *këtë*:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE PËR
PROJEKTE/PROGRAME TË ORGANIZATAVE JO-QEVERITARE

Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projekte/programet të organizatave jo-qeveritare në fushën e shëndetësisë, sipas kërkesë së Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, nr.13/59, dt.25.07.2018.

I

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores mbi Kriteret, Standardet dhe Procedura të financimit publik të OJQ-ve, Rregullorja nr.04/2017, *Ministrisë së Financave e Republikës së Kosovës.*

2. Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti i Komunës së Malishevës.

1. Mjetet e përmendura në nenin do të shpërndahen në bazë thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II. të këtij vendimi përfshinë:

1. Teksti i thirrjes publike
2. Udhëzimet për aplikantët
3. Formularët e aplikimit
4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve
5. Format për raportimin e zbatimit të projektit

2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:

1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
3. Forma e deklaramentit të mungesës së fondeve të dyfishta
4. Deklaratat e Partneritetit (nëse është e aplikueshme)
5. Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike.

6. Deklarata për Aktivitetet e kontraktorit, e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatimin (nëse aplikohet).
3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 1. Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit
 2. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin
 3. Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit

IV.

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare (ueb faqe).

V.

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.

VI.

1. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve.
2. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.
3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet si dhe drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale.

IX.

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit të njëjtë nga ana e kryetarit të komunës së Malishevës.

Kryetari i Komunës së Malishevës

Ragip Begaj
